



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
 Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

Tezat e masterit për diskutim publik të miratuara nga Departamenti i Mësimdhënies Lëndore
Me datë 07.06.2022

Vendimet për DISKUTIM PUBLIK					
#	Kandidati	Specializimi	Tema e punimit	Komisioni	
1	Florije Bytyci	Mës. GJLSH	Fjalët e panjohura shqipe për nxënësit e klasave VI-IX të shkollave fillore	Kryetar/e	Begzad Baliu
				Mentor/e	Naser Pajaziti
				Anetar/e	Xhavit Beqiri
2	Donika Gajraku	Mës. GJLSH	Shpjegimi i fjalëve të panjohura në tekstet shkollore 6 – 9	Kryetar/e	Xhavit Beqiri
				Mentor/e	Naser Pajaziti
				Anetar/e	Jehona Ferizi
3	Fëllanza Shotka Turtulla	Mës. Fizikë	Të nxënët e koncepteve në dinamikë nëpërmjet demonstrimeve në shkollat e mesme të ulëta	Kryetar/e	Ruzhdi Kuqi
				Mentor/e	Zeqir Shaqiri
				Anetar/e	Arlinda Damoni
4	Lumturie Hashani	Mës. GJLSH	Perceptimi i gjuhës nga nxënësit e klasave 6-9	Kryetar/e	Teuta Danuza
				Mentor/e	Begzad Baliu
				Anetar/e	Xhavit Beqiri
5	Fjolla Kaçamaku	Mës. Matematikë	Potenciali i teksteve të reja të matematikës për klasën e gjashtë për mësim bashkëkohor – rasti i konceptit të thyesës	Kryetar/e	Fahri Marevci
				Mentor/e	Valbona Berisha
				Anetar/e	Ganimete Kulinxha
6	Venera Hashani	Mës. Histori	Mësimdhënia e historisë në funksion të zhvillimit të mendimit kritik të nxënësit shkollave të mesme të ulëta	Kryetar/e	Kyvetë Shatri
				Mentor/e	Bahtije Gërbeshi
				Anetar/e	Rozafa Shala
7	Agon Krasniqi	Mës. Histori	Ndikimi i vlerësimit dhe ndërlidhjes së tij me rezultatet e të nxënët si dhe kriteret e suksesit në përvetësimin e përmbajtjeve historike	Kryetar/e	Ethem Ceku
				Mentor/e	Bahtije Gërbeshi
				Anetar/e	Vlora Sylaj
8	Adelina Shala Gjoshë	Mës. Histori	Roli i metodave bashkëkohore në përmirësimin e mësimdhënies së historisë sipas perceptimit të mësimdhënësve	Kryetar/e	Ethem Ceku
				Mentor/e	Bahtije Gërbeshi
				Anetar/e	Veli Kryeziu
9	Vlora Mustafa	Mës. dhe Kurrikula	Roli i lëndës së edukatës qytetare në përmirësimin e barazisë gjinore sipas perceptimit të mësimdhënësve	Kryetar/e	Nusret Pllana
				Mentor/e	Bahtije Gërbeshi
				Anetar/e	Ganimete Kulinxha
10	Alban Hasanaj	Mës. Matematikë	Zbatimi i teknikave në mësimdhënie për të nxënët më efikas të gjeometrisë	Kryetar/e	Eda Vula
				Mentor/e	Xhevat Krasniqi
				Anetar/e	Vlora Sylaj
11	Jeton Ganiu	Mës. Histori	Njohuritë e nxënësve të klasave VII-VIII të shkollave të mesme të ulëta lidhur me kulturën mesjetare	Kryetar/e	Ethem Ceku
				Mentor/e	Bahtije Gërbeshi
				Anetar/e	Begzad Baliu
12	Nezir Aliu	Mës. Histori		Kryetar/e	Nusret Pllana

			Mësimdhënia dhe të nxënit e lëndës së edukatës qytetare përmes punës me projekte në funksion të përmirësimit të rezultateve të të nxënit	Mentor/e	Bahtije Gërbeshi
				Anetar/e	Hatixhe Ismajli
13	Halime Haxhijaj	Mës. Histori	Përfaqësimi i kulturës shqiptare në tekstet e historisë të shkollave të mesme të ulëta sipas opinionit të nxënësve dhe mësimdhënësve	Kryetar/e	Ethem Ceku
				Mentor/e	Bahtije Gërbeshi
				Anetar/e	Vlora Sylaj
14	Egëzona Zeqa	Mës. Histori	Opinionet e mësimdhënësve lidhur me rolin e trajnimeve në përmirësimin e mësimdhënies në lëndën e historisë	Kryetar/e	Ethem Ceku
				Mentor/e	Bahtije Gërbeshi
				Anetar/e	Vlora Sylaj
15	Flora Musolli	Mës. Gjeografi	Fjalët e panjohura, përmbajtjet në tekstet shkollore në lëndën e Gjeografisë në klasat VI dhe VII	Kryetar/e	Arsim Ejupi
				Mentor/e	Nusret Pllana
				Anetar/e	Xhavit Beqiri
16	Fisnik Sollova	Mës. Histori	Vlerësimi i vazhdueshëm në lëndën e Edukatës Qytetare të nxënësit e klasave të nënta	Kryetar/e	Bahtije Gërbeshi
				Mentor/e	Veli Kryeziu
				Anetar/e	Hatixhe Ismajli

Kandidati/ja: 1. Florije Bytyci

Tema: Fjalët e panjohura shqipe për nxënësit e klasave VI-IX të shkollave fillore

ABSTRAKTI

Në këtë hulumtim do të studiohen fjalët e panjohura (huaja) në gjuhën shqipe, përkatësisht në tekstet letrare të klasave VI- IX të shkollave fillore. Duke e ditur se në librat e leximit letrar hasim shumë fjalë që nuk janë të njohura për nxënësit, pra qofshin ato të panjohura apo të huazuara, por që janë përdorur dhe fliten ende nga më të moshuarit.

Shumë shkrimtarë shqiptarë në tekstet shkollore mundohen që ta ruajnë gjuhën shqipe dhe vendosin edhe shumë fjalë shqipe në veprat e tyre që janë përdorur në të kaluarën dhe ndoshta disa prej tyre nuk përdoren më. Ka shumë fjalë shqipe që rrallë janë të pranishme në tekstet letrare shkollore, apo arrijmë t'i dëgjojmë.

Gjatë studimeve Bachelor dhe Master kam pasur rastin ta kryej praktikën në shkollë dhe kam vërejtur se në tekstet shkollore nxënësit nuk i kuptonin shumë fjalë edhe pse në gjuhën shqipe, sidomos fjalë apo shprehje që janë përdorur nga moshat e vjetra.

Në këtë punim do të përdoren disa metoda që kanë të bëjnë rreth temës së zgjedhur. Do të krahasohen fjalët e vjetra që janë përdorur në të kaluarën dhe fjalët që përdoren në ditët e sotme nga moshat të ndryshme të njerëzve e sidomos nga nxënësit e shkollave fillore.

Fjalët kyçe: shkollë, mësimdhënës, nxënës, fjalë, kuptim, vëmendje, etj.

Kandidati/ja: 2. Donika Gajraku

Tema: **Shpjegimi i fjalëve të panjohura në tekstet shkollore 6 – 9**

ABSTRAKTI

Përdorimi i fjalëve të panjohura ose barbarizmave në fjali ka një peshë të veçantë në ndërtimin (pasurimin dhe ruajtjen e gjuhës) dhe në paraqitjen e drejtë të mendimeve. Edhe ana metodologjike e didaktike e paraqitjes së tyre, mbetet thelbësore në kuptueshmërinë dhe besueshmërinë e trekëndëshit mësimdhënës – nxënës – kohë ose anasjelltas. Në këtë kumtim, këto do të jenë shtyllat kryesore të hulumtimit tonë. Përdorimi i drejtë i termave, përkufizimi dhe shpjegimi i tyre dhe rrjedhimisht të kuptuarit e tyre kanë rëndësi thelbësore në nxënien e të vërtetës shkencore në përgjithësi. Përdorimi i panevojshëm i fjalëve të huaja, mospërkufizimi i termave dhe mosangazhimi i mësimdhënësit për të shpjeguar kuptimin e termit apo fjalës së huaj është një nga pengesat kryesore të nxënies së materies lëndore përkatëse në shkollat tona. Tekstet e stërngarkuara, që nuk i përkasin stilit shkencor-mësimor janë stilistikisht të rënda dhe jo të lehta për t'i mësuar dhe kuptuar nxënësi. Në vëzhgim kemi marrë terminologjinë e përdorur në librat mësimorë të gjuhës shqipe për klasat 6 – 9, në Kosovë. Këto tekste mësimore janë mjaft të rëndësishme për pasurimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të gjuhës standarde shqipe të nxënësve të shkollave të mesme të ulta. Ndërkaq, mundësia e zëvendësimit të fjalëve me burim të huaj me gjegjëset në gjuhën shqipe, konsiderojmë dhe vlerësojmë se do të jetë me interes të veçantë e të duhur për të bërë pasqyrimin dhe plotësimin e “objektivave gjuhësore” të cilat, meritojnë që gjuha standarde shqipe të jetë e pastër dhe e kuptueshme për nxënësit, si dhe të respektojë në masë të duhur zhvillimin dhe aftësitë e tyre psikofizike e gjuhësore, duke mos përdorur fjalë apo terma që nuk kanë kuptim, ose që kanë kuptim të pjesshëm.

Mesazhi i këtyre teksteve mësimore është që nxënësit, ndodhitë, ngjarjet e situatat e caktuara në mjedise e kohë të ndryshme, t'i kuptojnë saktë dhe t'i interpretojnë drejt.

Fjalët kyçe: didaktikë, gjuhë shqipe, mësimnxënie, nxënës, objektiva, term

Kandidati/ja: 3. Fëllanza Shotka Turtulla

Tema: Të nxënit e koncepteve në dinamikë nëpërmjet demonstrimeve në shkollat e mesme të ulëta

ABSTRAKTI

Dinamika është njëra ndër temat në fizikë e cila shtjellohet në klasën e tetë, padyshim në të nxënit e saj rol të rëndësishëm dhe mjaft efikas kanë edhe demonstrimet. Kurrikula e fizikës së shkollës 9 vjeçare ka për mision të kontribuojë në përgatitjen e të gjithë nxënësve për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe për ta përdorur fizikën në vendimmarrje që të ndihmojë në zhvillimin e tyre si individ dhe të komunitetit në nivel lokal, kombëtar e ndërkombëtar.

Qëllimi i këtij hulumtimi parashihet të vë në pah mendimet e mësimitdhënësve dhe nxënësve lidhur me të nxënit e koncepteve në dinamikë në mësimitdhënie dhe mësimitnxënie efektive me anë demonstrimeve. Në këtë hulumtim janë paraparë edhe perceptimet e mësimitdhënësve lidhur me demonstrimet, sa i praktikojnë dhe cilat janë kushtet që ofrojnë shkollat për demonstrim të lëndës. Po ashtu, është analizuar se cila është mënyra më efektive për përfundimin e një demonstrimi: nga mësimitdhënësi apo nga vet nxënësi.

Në Komunën e Prizrenit janë gjithsej 86 shkolla publike dhe 3 private. Për mbledhjen e të dhënave në këtë hulumtim është përdorur metoda e përzier (sasiore dhe cilësore). Grupin punues do ta formojnë 6 mësimitdhënës të cilët ligjërojnë lëndën e fizikës në shkollat të mesme të ulët dhe 120 nxënës, prej tyre 50 nxënës të klasave të teta nga shkolla e mesme e ulët “Emin Duraku” Prizren, 50 nxënës nga shkolla e mesme e ulët “Mustafa Baku” Prizren, 20 nxënës nga kolegji “International Maarif Schools of Kosova” Prizren, dhe nga 2 mësimitdhënës për secilën shkollë.

Për të kuptuar perceptimet e nxënësve dhe mësimitdhënësve lidhur me demonstrimin dhe se sa përdoren ato në shkollat e tyre, mësimitdhënësve i është përpiluar një intervistë me pyetje të strukturuar dhe gjysmë të strukturuar. Duke u bazuar në qëllimin e hulumtimit, është ngritur një pyetje kryesore e hulumtimit si dhe dy nënpyetje në lidhje me atë se: Sa përdoren demonstrimet në lëndën e Fizikës në të kuptuarit e koncepteve në dinamikë? dhe A ndikon zhvillimi profesional i mësimitdhënësve në përdorimin e demonstrimeve për të sqaruar konceptet dinamike? Po ashtu, janë ngritur dy hipoteza: H1: Përdorimi i demonstrimeve në Fizikë ndihmon në të kuptuarit më të mirë të koncepteve në dinamikë. H2: Zhvillimi profesional i mësimitdhënësve ndikon në të kuptuarit më të mirë të koncepteve dinamike. Në bazë të rezultateve të dalta, do të nxjerrim në pah rolin e eksperimentit në mësimitdhënie dhe mësimitnxënie efektive në fushën e shkencave, përkatësisht në dinamikë gjithashtu do të nxjerrim rekomandime të cilat do të mund të ndikojnë në përmirësimin apo në zbatimin në mënyrë sa më efektive të eksperimentit në procesin e mësimitdhënies dhe mësimitnxënie.

Fjalët kyçe: demonstrimi, dinamika, mësimitdhënia, mësimitnxënia

Kandidati/ja: 4. Lumturie Hashani

Tema: **Perceptimi i gjuhës nga nxënësit e klasave 6-9**

ABSTRAKTI

Gjuha është mjet i komunikimit për shoqërinë në përgjithësi dhe njëherazi pasqyrë e identitetit të një populli. Përmes gjuhës një nxënës i shkollës fillore dhe të mesme të ulët, arsimohet dhe merr dije, kulturë, edukatë nga lëndë të ndryshme mësimore.

Mësimdhënia dhe mësimnxënia në njërën anë, gjuha e kultura në anën tjetër janë thelbësisht të lidhura me njëra-tjetrën, boshti kryesor rreth të cilit organizohet Kurrikuli Bërthamë i planprogrameve mësimore. Si perceptohet gjuha standarde shqipe nga aktorët kryesorë në mësimdhënie: nxënësi dhe arsimtari? Një hulumtim dhe analizë e kësaj çështjeje do të bëhet në kontakt me literaturën dhe me nxënësin e mësimdhënësin me qëllimin e dhënies së kontributit, përmirësimit dhe ndërgjegjësimit, për t'u fokusuar te të folurit në gjuhën standarde, te shkrimi dhe ofrimi i mundësisë që nxënësit të kuptojnë domethënien e fjalës *gjuhë* edhe përtej kuptimit të saj të parë.

Fjalët kyçe: gjuhë, identitet, mësimdhënie, nxënës, standard

Kandidati/ja: 5. Fjolla Kaçamaku

Tema: Potenciali i teksteve të reja të matematikës për klasën e gjashtë për mësim bashkëkohor – rasti i konceptit të thyesës

ABSTRAKTI

Fokusi i këtij hulumtimi është shqyrtimi i potencialit të teksteve të reja të matematikës të klasës së gjashtë për mësimin bashkëkohor të konceptit të thyesës. Hulumtimi mbështetet në dy arsye kyçe: (i) tekstet shkollore kanë rol fundamental në mësimdhënien dhe nxënien e përditshme të matematikës (ii) koncepti i thyesës është një koncept kompleks dhe mjaft problematik për nxënie si në shkollën fillore ashtu edhe në atë të mesme të ulët, prandaj përpjekjet duhet të jenë maksimale në drejtim të mundësive të ofruara për nxënien e thellësishme dhe të kuptimshme të këtij koncepti. Korniza analitike e këtij hulumtimi përfshinë katër dimensione analitike: dimensionin kurrikular, dimensionin pedagogjik, dimensionin e përfaqësimit dhe të komunikimit, si dhe dimensionin shkencor. Këto dimensione janë me shumë peshë për mësimdhënien dhe nxënien bashkëkohore të koncepteve matematike dhe nga ana tjetër, janë në përputhje të plotë me funksionet primare të një teksti bashkëkohor shkollor të matematikës. Në këtë studim rasti, është performuar një analizë vertikale e teksteve shkollore të matematikës për klasën e gjashtë për konceptin e thyesës. Rezultatet e këtij hulumtimi tregojnë se tekstet e analizuara nuk e përfaqësojnë me besnikëri kurrikulën e synuar shtetërore, nuk i furnizojnë mësimdhënësit me ide për aktivitete të ndryshme, metoda e teknika të suksesshme bashkëkohore për zhvillimin e mësimin në klasë, nuk e përfaqësojnë plotësisht konceptin e thyesës, si dhe nuk kanë saktësi në paraqitjen shkencore të konceptit të thyesës dhe përmbajtjeve të prezentuara në lidhje me këtë koncept. Si përfundim, tekstet në fjalë nuk kanë potencial të mjaftueshëm për realizimin e mësimin bashkëkohor të konceptit të thyesës.

Fjalët kyçe: Tekstet e matematikës, Analizë, Thyesë, Shkollë e mesme e ulët

Kandidati/ja: 6. Venera Hashani

Tema: Mësimdhënia e historisë në funksion të zhvillimit të mendimit kritik te nxënësit e shkollave të mesme të ulëta

ABSTRAKTI

Mësimdhënia bashkëkohore nënkupton ndryshimin e roleve të mësuesit dhe të nxënësit, ndryshimin e metodologjisë së punës, përdorimin e aktiviteteve mësimore brenda orës mësimore me qëllimin kryesor lehtësimin e të nxënësve, zhvillimin e mendimit kritik si dhe avancimin e mësimdhënies. Punimi “Mësimdhënia e historisë në funksion të zhvillimit të mendimit kritik te nxënësit e shkollave të mesme të ulëta” ka për qëllim të paraqes rolin e lëndës së historisë në zhvillimin e mendimit kritik te nxënësit e shkollave të mesme të ulëta, sipas perceptimit të nxënësve dhe mësimdhënësve. Por përdorimi i aktiviteteve të ndryshme në klasë siç janë: inserti, miniprojekti, debate, kuize diturie si asociacioni, gara, gjatë realizimit të orës mësimore në lëndë të ndryshme, e veçanërisht në lëndën e historisë, si dhe portofolio mendohet se është shumë i domosdoshëm për zhvillimin e mendimit kritik te këta nxënës. Prandaj aktivitetet e ndryshme mësimore do të jenë pjesë e këtij hulumtimi, me qëllimin për të parë se a nxisin apo jo të menduarit e tyre kritik. Këto aktivitete por edhe shumë të tjera mendohet se i përgatisin nxënësit për sfidat e shekullit XXI, i bëjnë ata më të përgjegjshëm dhe konkurrues për tregun e punës. Sa i përket natyrës së hulumtimit, ajo do të gërshetohet ndërmjet metodës sasiore dhe asaj cilësore, ndërsa, dizajni i hulumtimit do të bëhet në kombinim me tri metoda: me nxënësit do të zhvillohet një pyetsor gjysmë i strukturuar dhe vrojtimi, kjo do të na ndihmojë për të parë se sa e kanë të zhvilluar mendimin kritik nxënësit, më pas do të vazhdojmë me përdorimin e teknika të ndryshme mësimore për zhvillimin e mendimit kritik. Ndërsa me mësimdhënësit do të zhvillohet një intervistë gjysmë e strukturuar, por gjithashtu edhe do të i vrojtojmë mësimdhënësit për të parë se sa po e zhvillojnë të menduarit kritik tek nxënësit. Siç u cekë dhe më lart do të zhvillohet pyetësori me nxënësit, intervista me mësimdhënësit, ndërsa me të dyja palët do të bëhet vëzhgimi. Hulumtimi do të zhvillohet në komunat: Prishtinë, Obiliq, Gjilan. Arsyeja pse është bërë përzgjedhja e këtyre komunave është sepse Prishtina ka numrin më të madh të nxënësve dhe qëllimi është për me kuptu se sa zhvillohet mendimi kritik, e njejtja gjë vlen edhe për komunën e Gjilanit ndërsa komuna e Obiliqit është komuna që formon një trekëndësh ndërmjet këtyre komunave. Pra përzgjedhja e tyre është bërë në mënyrë të qëllimshme, ndërsa shkollat, klasat do të zgjidhen me konvenencë.

Rezultatet e këtij studimi, kanë për synim që të gjenden rezultate reale dhe bindëse të cilat do të rezultojnë nga të dhënat të cilat i kemi marr nga terreni. Gjetjet do të jenë shumë interesante dhe të rëndësishme, kjo për faktin sepse do të kuptohet se sa nxënësit e kanë të zhvilluar të menduarit kritik dhe sa mësuesit kanë qëndrime pozitive në zhvillimin e mendimit kritik te nxënësit e tyre. Rezultatet e dalta nga hulumtimi priten të ndikojnë në sensibilizimin e rolit që ka zhvillimi i mendimit kritik te nxënësit dhe në këtë formë të ndikojnë edhe në arritjen e rezultateve të pritura që janë të përcaktuara në Kornizën Kurrikulare të Kosovës.

Fjalët kyçe: historia, mësimdhënia, mendimi kritik, nxënësi, teknikat.

Kandidati/ja: 7. Agon Krasniqi

Tema: Ndikimi i vlerësimit dhe ndërlidhjes së tij me rezultatet e të nxënit si dhe kriteret e suksesit në përvetësimin e përmbajtjeve historike

ABSTRAKTI

Objekt i këtij punimi është studimi rreth ndikimit të vlerësimit, rezultateve të të nxënit dhe kriterëve të suksesit të nxënësve në përvetësimin e përmbajtjeve historike. Gjatë këtij punimi do të shtjellohet edhe procesin e mësimdhënies, vlerësimin si tërësi, duke filluar nga procesi i vlerësimit për të vazhduar me qëllimin e vlerësimit, parimet e vlerësimit, llojet e vlerësimit, rezultatet e të nxënit. Të gjitha këto do t'i elaborojmë duke bërë krahasime, analizë në bazë të burime të shumta që kemi përdorur, si libra, revista, materiale nga MASHT- i, intervista, pyetësorë, materiale nga intereneti.

Punimi do të bazohet në hulumtim sipas metodës kualitative dhe kuantitative, bazuar në instrumentent relevante për secilën metodologji (intervistës së gjysmëstrukturuar për mësimdhënës si dhe pyetësorëve për nxënës). Hulumtimi do të bazohet në një popullacion prej 1047 nxënësve dhe mostrës prej 250 nxënësve, të klasave 6,7,8,9. Intervistat do të zhvillohen me gjithsej 9 mësimdhënës të historisë nga katër shkollat e mëposhtme.

Hulumtimi do të realizohet në SHMU “SHMU-2” , SHMU “SHMU-1” , SHFMU“Andon Zako Cajupi” , në qytetin e Vushtrrisë si dhe në shkollën SHFMU “Pandeli Sotiri”, në Obiliq, komuna e Obiliqit.

Pyetjet hulumtues do të jenë si në vijim: Çfarë ndërlidhje ka ndërmjet procesit të vlerësimit me rezultatet e të nxënit dhe kriteret e suksesit? Çfarë ndikimi kanë rezultatet e të nxënit dhe kriteret e suksesit, në përvetësimin e përmbajtjeve historike? Cilat nivele të njohurive sipas taksonomisë së Bloom-it, janë shfrytëzuar nga mësimdhënësit gjatë përpilimit të testeve në lëndën e historisë? Pra, përmes këtij hulumtimi synojmë të arrijmë një konkluzion se sa ndikon vlerësimi dhe ndërlidhja e tij me rezultatet e të nxënit dhe kriteret e suksesit në përvetësimin e përmbajtjeve historike.

Fjalët kyçe: kriteret e suksesit, nxënësit, procesi i vlerësimit, rezultatet e të nxënit, shkolla.

Kandidati/ja: 8. Adelina Shala Gjosh

Tema: Roli i metodave bashkëkohore në përmirësimin e mësimdhënies së historisë sipas perceptimit të mësimdhënësve

ABSTRAKTI

Qëllimi i këtij hulumtimi është që të paraqesum një analizë të përdorimit të metodave bashkëkohore dhe cili është roli i përdorimit të tyre në përmirësimin e mësimdhënies së lëndës së historisë. Gjithashtu për realizimin e këtij hulumtimi ne shfrytëzuam instrumente adekuate, si pyetësorë për mësimdhënësit dhe nxënësit si dhe intervista të gjysmëstrukturuara për mësimdhënësit.

Mësimdhënia bashkëkohore është ajo mësimdhënie që e lehtëson të nxënit e nxënësve përmes metodave dhe strategjive të përshtatshme. Ajo nënkupton ndryshimin e roleve të mësuesit dhe nxënësit, pjesëmarrjen e të gjithë komunitetit dhe faktorëve që ndikojnë në mësimdhënie. Më mësimdhënie bashkëkohore, duhet të kuptojmë atë lloj mësimdhënie e cila lehtëson me forma, metoda, teknika dhe strategji të përshtatshme në procesin e të nxënit të nxënësve. Në teorinë dhe praktikën e punës mësimore, çështja e metodave është një nga problemet me rëndësi të veçantë, meqë ato shoqërojnë tërë ecurinë e zhvillimit të procesit mësimor.

Hulumtimi është zhvilluar me mësimdhënësit e historisë së shkollave të mesme të ulta në Mitrovicë. Si instrument për grumbullimin e të dhënave është përdorur pyetësori i ndërtuar enkas për mësimdhënësit dhe nxënësit si dhe intervista me mësimdhënësit. Numri i respondentëve të cilët kanë marr pjesë në plotësimin e pyetësorit është 11 mësimdhënësit dhe 80 nxënësit. Ndërsa i kemi intervistuar 5 mësimdhënësit. Analiza e rezultateve është bërë duke përdorur programin e statistikor SPSS, konkretisht modelet Descriptive dhe Anova; që mundësuan shqyrtimin e relacioneve ndërmjet variablave. Të gjeturat na ofruan një pasqyrë të kompletuar e të hollësishme të perceptimeve të mësimdhënësve në lidhje me përdorimin dhe rolin e metodave bashkëkohore në lëndën e historisë.

Përceptimet e mësimdhënësve e të nxënësve të anketuar në lidhje me përdorimin e metodave bashkëkohore ishin tejet pozitive. Të dhënat e hulumtimit treguan që nxënësit që mësojnë përmes metodave bashkëkohore kanë rezultate më të larta në lëndën e historisë në krahasim me nxënësit që nuk përdorin. Punimi është i metodës kuantitative dhe kualitative.

Fjalët kyçe: metodë, mësimdhënie, histori, mësimdhënësit, nxënësit, të nxënit.

Kandidati/ja: 9. Vlora Mustafa

Tema: Roli i lëndës së edukatës qytetare në përmirësimin e barazisë gjinore sipas perceptimit të mësimitdhënësve

ABSTRAKTI

Lënda e edukatës qytetare është pjesë e kurrikulës arsimore dhe mësohet në arsimin e detyruar. Ajo më parë mësohej nga klasa V deri në klasën e IX ndërsa tani mësohet nga klasa e I, mirëpo prej klasës III kalon në lëndë obligative sepse nga klasa e parë është vetëm lëndë zgjedhore dhe njihet me emrin shoqëria dhe mjedisi. Kjo tregon për ndryshimet të cilat po ndodhin vazhdimisht në shoqërinë tonë, mirëpo, gjithashtu është edhe një sfidë për vet lëndën e edukatës qytetare, në veqanti për mësimitdhënësin e kësaj lënde i cili duhet të jetë në gjendje të zgjedhë dhe përshtatë metodat dhe teknikat e duhura për nxënësit të cilët tani e tutje do ta kenë këtë lëndë obligative sikurse lëndët tjera.

Hulumtimi i kësaj teme në këtë kohë është i rëndësishëm për arsye se mund të shërbejë si referencë për ata studiues të cilët dëshirojnë të hulumtojnë rreth kësaj çështje, e cila nuk është trajtuar nga asnjë studiues nga i njëjti këndvështrim, pra nuk gjendet literaturë e cila tregon se cili është roli i lëndës së edukatës qytetare në përmirësimin e barazisë gjinore sipas perceptimit të mësimitdhënësve në shoqërinë tonë.

Metodat dhe teknikat të cilat i kam përdorur për të realizuar këtë punim, kanë të bëjnë me kriteret me të cilat do të ndjekë në përzgjedhjen e literaturës. Mikse (e përzier), sasiore dhe cilësore, bazuar në qëllimet dhe pyetjet, pa përjashtuar edhe metodën e analizës teorike dhe statistikore. Sa i përket instrumenteve kam përdorur pyetësorin të cilin e kam realizuar me ndihmën e mësimitdhënësve të edukatës qytetare në katër shkolla fillore të mesme të ulëta në komunën e Gjilanit, dy nga qyteti dhe dy nga fshati. Të gjithë këta mësimitdhënës janë përgjegjës për pyetjet kryesore të hulumtimit e cila ka qenë: Cili është roli i lëndës së edukatës qytetare në përmirësimin e barazisë gjinore sipas perceptimit të mësimitdhënësve? Si dhe gjithashtu pyetësori tjetër i cili është realizuar me nxënësit. Rezultatet kryesore të këtij hulumtimi kanë vërtetuar hipotezën e këtij hulumtimi e cila është: Barazia gjinore do të përmirësohet nëse lëndës së edukatës qytetare do të rritej numri i orëve mësimore. Rezultatet e këtij hulumtimi kanë treguar se sa i rëndësishëm ka qenë dhe është roli i edukatës qytetare në edukimin e shoqërisë sonë rreth barazisë gjinore.

Fjalët kyçe: edukim, qytetari, gjini, barazi gjinore, drejtësi gjinore etj.

Kandidati/ja: 10. Alban Hasanaj

Tema: Zbatimi i teknikave në mësimdhënie për të nxënit më efikas të gjeometrisë

ABSTRAKTI

Qëllimi i këtij hulumtimi është shtjellimi i qëndrimeve të mësimdhënësve lidhur me zbatimin e teknikave të përdorura për të nxënit me efikas të gjeometrisë dhe gjetja e teknikave për të nxënit më efikas të gjeometrisë.

Ministria e arsimit, shkencës, teknologjisë dhe inovacionit (MASHTI), me kornizën kurrikulare dhe kurrikula bërthamë, ka përcaktuar përfaqësimin, shtrirjen dhe organizimin e secilës fushë kurrikulare dhe lëndëve mësimore brenda fushave përkatëse. Në këtë kontekst, edhe fushën kurrikulare matematika në kuadër të së cilës përmbahet edhe gjeometria.

Teza e këtij punimi të masterit është "Zbatimi i teknikave në mësimdhënie për të nxënit më efikas të gjeometrisë". Duke u bazuar në teknikat që përdoren nga mësimdhënësit për mësimdhënien e gjeometrisë, nëpërmjet këtij punimi kemi nxjerrur përfundimin se cilat janë teknikat me të zbatueshme për të nxënit me efikas të gjeometrisë për SHMU (klasat VI - IX).

Gjithashtu gjatë këtij punimi është bërë një hulumtim me mësimdhënës nëpërmjet të cilit kemi nxjerrur dhe analizuar të dhënat përkatëse. Nga përfundimet e nxjerrura kemi vënë në pah rëndësinë e zbatimit të teknikave dhe cilat janë ato teknika për mësimdhënie sa më efikase të gjeometrisë si dhe rëndësinë e tyre që kanë në ngritjen e cilësisë në të nxënë.

Fjalët kyçe: Qëndrime, mësimdhënie, teknikë, cilësi, zbatim, efikas.

Kandidati/ja: 11. Jeton Ganiu

Tema: Njohuritë e nxënësve të klasave VII-VIII të shkollave të mesme të ulëta lidhur me kulturën mesjetare

ABSTRAKTI

Procesi edukativo-mësimor është një proces i cili në përbërjen e vet ka aspekte nga më të ndryshmet përmes së cilit realizohet i tërë ky proces. Kultura në procesin edukativo-mësimor paraqet një pjesë shumë të rëndësishme të këtij procesi. Në këtë hulumtim do të trajtohet tema: Njohuritë e nxënësve të klasave VII-VIII të shkollave të mesme të ulëta lidhur me kulturën mesjetare. Në këtë hulumtim hapësire e veçantë i kushtohet kulturës mesjetare shqiptare.

Ky hulumtim do të realizohet me anë të metodologjisë sasiore dhe cilësore, ndërsa si instrument matës do jetë pyetësi për nxënës dhe për mësimdhënës të lëndës së historisë. Pyetësorët do të realizohen me nxënësit e klasave të VII-VIII në katër shkolla në qytetin e Podujevës që janë: “Naim Frashëri”, “Shaban Shala”, “Ibrahim Rugova”, “Xheladin Rekalii” dhe “Enver Maloku”.

Po ashtu do të jenë edhe tri shkolla në fshatra të Komunës së Podujevës, “Dëshmoret e Kombit”-Balloc, “Ali Ajeti”-Sfeqël, “Musli Dumoshi”-Dumosh dhe “Kongresi i Manastirit”-Gllamnik. Po ashtu do të realizohen pyetësor mësimdhënës të lëndës së historisë në shkollat ku do të realizohen këta pyetësorë. Pra, duke u ndërlidhur kriteri tematik me atë kronologjik, ky punim është i ndarë në disa kapituj. Struktura e këtij punimi do të jetë e përbër nga pesë kapituj që janë: hyrje, shqyrtim i literaturës, metodologjia, analiza e rezultateve dhe konkludim.

Në këtë hulumtim pritet që të nxiren rezultate që kanë të bëjnë me nivein e njohurive të nxënësve për kulturen mesjetare, për vështirësitë që hasin për të arritur këto njohuri e kështu me radhë.

Fjalët kyçe: historia, kultura, mësimdhënia, mesjeta.

Kandidati/ja: 12. Nezir Aliu

Tema: Mësimdhënia dhe të nxëniet e lëndës së edukatës qytetare përmes punës me projekte në funksion të përmirësimit të rezultateve të të nxëniet

ABSTRAKTI

Procesi mësimor ka pësuar vazhdimisht ndryshime në konceptim dhe në zbatim me synim realizimin cilësor të mësimnxënies dhe formimin e personalitetit të nxënësit nëpërmjet lidhjes së ngushtë të teorisë me praktikën. Suksesi i procesit kërkon jo vetëm kombinim efektiv të faktorëve mësimorë të shumtë e të ndryshëm, por edhe vlerësim të tyre. Prandaj studimi kishte për qëllim vlerësimin e dinamikës dhe efektivitetit të procesit të mësimdhënie-mësimnxënie bazuar në mësimin me projekte në përmisimin e rezultateve të të nxëniet në lëndën e edukatës qytetare, që si lëndë është mjaftë komplekse dhe kërkon një trajtim të veçantë sepse ka të bëjnë në radhë të parë me mirëqenien e tyre të përbashkët si qytetar i përgjegjshëm dhe aktiv në të ardhmen.

Për analizë u morën të dhënat e rezultateve të 627 nxënësve, të klasës së VIII-të dhe IX- të, po ashtu për një analizë së cilësore janë anketuar 30 mësimdhënës. Për analizë sa më reale në studim janë përfshirë disa shkolla edhe ato në qytet por edhe ato në fshatra për të analizuar se a janë kushtet e njëjta edhe në vendet rurale si në atë urban, në rastin tonë qytetin e Lipjanit, që përveç tij janë përfshirë disa fshatra të komunës së Lipjanit si: Gadime, Ribar i Madh, Blinaj, Miren, Janjevë, Dobrajë e Madhe, Magurë, Baicë, Torinë, Grack dhe Jeta e Re. Përveç kësaj kanë marrë pjesë edhe 5 zyrtarë komunal. Studimi ka zgjatur dy vite dhe ka përfshirë shqiptarët dhe komunitetet pakicë.

I gjithë procesi ka për objektiv realizimin cilësor të produktit përfundimtar që është rezultati i nxënësit. Procesi ka evoluar në metodologji, strukturë, mjete mësimdhënie, duke u kthyer në një proces bashkëveprimi aktiv mësues-nxënës. Procesi mësimor, nëpërmjet lidhjes së teorisë me praktikën, synon: realizimin cilësor të mësimnxënies, formimin e personalitetit të nxënësit.

Fjalë kyçe: Edukata Qytetare, mësimi përmes projekteve, kompetenca qytetare, projekt qytetar, qytetari aktive.

Kandidati/ja: 13. Halime Haxhijaj

Tema: Përfaqësimi i kulturës shqiptare në tekstet e historisë të shkollave të mesme të ulëta sipas opinionit të nxënësve dhe mësimeve

ABSTRAKTI

Duke marrë parasysh se arsimit i shoqërisë është segmenti më i rëndësishëm i një shteti, atëherë ne duhet që në vazhdimësi të bëjmë përpjekje për ta zhvilluar, e madje edhe perfeksionuar atë. Me anë të këtij studimi kam bërë përpjekje për të hulumtuar dhe paraqitur opinionet e mësimeve lidhur me përfaqësimin e kulturës shqiptare në tekstet e historisë të shkollave të mesme të ulëta.

Në tekstet mësimore të historisë, arsimi dhe kultura shqiptare mësohen nga nxënësit e shkollave të mesme të ulëta në Kosovë. Se sa këto tekste mësimore ofrojnë njohuri lidhur me këtë çështje, ne do të shohim në vijim ku kam hulumtuar opinionet e mësimeve dhe të nxënësve.

Lënda e historisë ka për qëllim zhvillimin e aftësive për të njohur dhe për të kuptuar ngjarjet, mënyrat e jetesës, personalitetet historike, kthesat historike, vendet dhe institucionet shoqërore e shtetërore, besimet, të arriturat ekonomike, arsimore, shkencore, kulturore etj.

Kultura përfshin besimin tonë, sjelljen, mënyrën se si e konceptojmë rrethin dhe këndvështrimin tonë. Pjesët më të mëdha të kulturës trashëgohen më tej nëpërmjet familjes ose bashkësisë. Secila kulturë bazohet në tre elemente: kuptimet, zakonet dhe objektet. Detyrë e parë që do të shtrohet në këtë punim krahasimor është evidentimi se kultura shqiptare ka një histori autoktone të lashtë nga periudha ilire – pellasge e trashëguar, e cila në vete nganjëherë ngërthente edhe tiparet nga kulturat e popujve të tjerë.

Ndërsa, detyrë e dytë është studimi i transformimit të kulturës shqiptare pas vitit 1990, ku është evidente se një pjesë e madhe e këtyre vlerave janë humbur ose po tjetërsohen dita-ditës, por edhe depërtimi i vlerave të tjera, të panjohura më parë.

Fjalë kyçe: Kultura, shqiptaret, tekstet e historisë, nxënësit, mësimeve.

Kandidati/ja: 14. Egëzona Zeqa

Tema: Opinionet e mësimitdhënësve lidhur me rolin e trajnimeve në përmirësimin e mësimitdhënies në lëndën e historisë

ABSTRAKTI

Ky studim ka për qëllim të paraqes një analizë të opiniove të mësimitdhënësve lidhur me rolin e trajnimeve, përmirësimin e mësimitdhënies në lëndën e historisë në Shfmu V-IX. Rëndësia e këtij studimi është mjaft e madhe, sepse synon të instaloj një praktikë të marrjes së vendimeve përmes analizës së opinionit përkatës të personave të përfshirë në procesin e zhvillimit të shkollës dhe arsimit në përgjithësi, ku dihet që barra më e madhe për futjen dhe implementimin e risive bie pikërisht mbi udhëheqësit e shkollave. Po ashtu, studime të tilla nuk janë zhvilluar deri më tani në Kosovë.

Ky hulumtim do të realizohet me mësimitdhënësit dhe nxënësit e shkollave së mesme të ulëta dhe është i bazuar në pyetësor, intervista si dhe në vëzhgime të drejtpërdrejta në orët mësimore. Hulumtimi do të përfshijë disa paralele nga shkolla të ndryshme të klasave të ndryshme të SHFMU në komunën e Vushtrrisë. Si metodologji do të përdorim hulumtimin në veprim, ndërsa të dhënat do të merren nga disa klasa me nga njëzet nxënës, që përbëjnë mostrën këtij studimi. Objektivi kryesor i kësaj teme lidhet me strategjitë klasike dhe bashkëkohore të udhëheqjes së shkollave gjatë historisë që janë të ndryshme varësisht nga zhvillimet e kohës nëpër të cilat ka kaluar shoqëria, tranzicioni, problemet, dobët dhe dobësitë të cilat kanë dalë si rezultat i ndryshimeve që lidhen edhe më fushën e arsimit dhe edukimit. Gjatë hulumtimit do të respektojmë hapat e paraparë në doracak, duke filluar me abstraktin, hyrjen, shqyrtimin e literaturës, definimin e problemit, analizës së pyetjeve dhe hipotezave etj.

Njohim mirë natyrën e punës që lënda e Historisë ka, andaj do të shohim nga afër trajnimet që mësimitdhënësve të kësaj lënde u ofrohet, në mënyrë që ata ta praktikojnë sa më lehtë dhe me efikasitet këtë lëndë para nxënësve.

Do të marrim mendimet e mësimitdhënësve lidhur me rolin e këtyre trajnimeve, cilësisë së trajnimeve, ndikimit që këto trajnime luajnë tek mësimitdhënësia ose metodologjia e tyre etj.

Fjalët kyçe: Menaxhimi, performanca, strategjitë, udhëheqja, vlerësimi, rol .

Kandidati/ja: 15. Flora Musolli

Tema: Fjalët e panjohura, përmbajtjet në tekstet shkollore në lëndën e Gjeografisë në klasat VI dhe VII

ABSTRAKTI

Lënda e Gjeografisë përmban në vete terma gjuhësor shpeshherë të panjohura për nxënësit e sidomos ata të moshave më të vegjël. Në këtë punim synojmë të vëm në pah fjalët e panjohura në tekstet e gjeografisë, njëkohësisht të bëjmë krahasim në mes të teksteve të klasave 6 dhe 7. Në bashkëpunim me mësimdhënësit e kësaj lënde do të paraqesim edhe vështirësitë në të cilat ata hasin gjatë përdorimit të teksteve të kësaj lënde, didaktiken të cilën ata e përdorin me nxënës dhe nëse ndonjëherë përdorin tekste alternative gjatë orës mësimore.

Përmes pyetësorëve nxënësit dhe mësimdhënësit do të shprehin mendimet e tyre, do të paraqesin fjalët e huaja nëse i kanë hasur në tekste, ana didaktike etj. Përmes këtij hulumtimi synojmë të paraqesim edhe ngarkesën e përmbajtjeve mësimore, të shohim nëse këto tekste janë në përputhje me Kornizën Kurrikulare të Kosovës.

Nga afër do të shohim edhe mundësinë që këto tekste u japin nxënësve për zhvillimin e shkathtësive komunikuese, apo u ndihmon vetëm për fakte gjeografike. Lënda e Gjeografisë u mundëson nxënësve të përdorin gjuhën hartografike por sa kanë problem nxënësit me fjalë të huaja ose të panjohura në tekstet shkollore, të gjitha këto do të paraqesim në këtë punim.

Përmes këtij hulumtimi do të bëjmë një krahasim të teksteve të vjetra me tekstet e reja të lëndës së Gjeografisë, dhe do të paraqesim dallimet, vështirësitë dhe të mirat e këtyre teksteve për nxënësit.

Fjalët kryesore: Gjeografi, tekste, hulumtim, fjalë e huaj, Korniza Kurrikulare.

Kandidati/ja: 16. Fisnik Sollova

Tema: Vlerësimi i vazhdueshëm në lëndën e Edukatës Qytetare te nxënësit e klasave të nënta

ABSTRAKTI

Në këtë punim të masterit kemi trajtuar temën “Vlerësimi i vazhdueshëm në lëndën e Edukatës Qytetare te nxënësit e klasave të nënta”, jemi munduar të sjellim mënyrën e vlerësimit bazuar në aplikimin e kurrikulit te ri në procesin e arsimit të Kosovës.

Dihet se vlerësimi është një proces tejet i rëndësishëm për nxjerrjen e rezultateve të nxënësve. Sot është shumë i aplikueshëm në vendin tonë vlerësimi formativ, mësimdhënësit mund të përdorin një rrjet të gjerë të instrumenteve për të vlerësuar kompetencat e nxënësve si: shkathhtësitë, qëndrimet dhe vlerat e tyre, jo vetëm dijet dhe njohuritë por edhe faktet. Lënda e Edukatës Qytetare është shumë e rëndësishme pasi që përmes kësaj lëndë nxënësit nxiten të krijojnë vlera qytetare dhe ti respektojnë vlerat e shoqërisë demokratike, këto vlera mund të jenë: të drejtat e njeriut, toleranca, barazia, liria, paqja, drejtësia, etj.

Në këtë hulumtim metodologjinë të cilën kemi përdorur metodën e përzier, cilësore dhe sasiore, që mundëson përgjigjen në pyetjen e parashtruar në hulumtim, të dhënat sasiore janë realizuar përmes programit kompjuterik statistikor, ndërsa të dhënat cilësore janë realizuar përmes metodës deskriptive (përshkruese). Qëllimi i hulumtimit është analizimi i vlerësimit të vazhdueshëm në lëndën e Edukatës Qytetare. Për mostrën e këtij hulumtimi kemi përzgjedhur 100 nxënës nga pesë shkolla në Komunën e Fushë Kosovës, nxënës të klasave të nënta dhe 15 mësimdhënës.

Nga ky hulumtim kemi nxjerrë përfundime për rëndësinë e vlerësimit të vazhdueshëm në lëndën e Edukatës Qytetare te nxënësit e klasave të nënta, që mund t’iu shërbejnë mësimdhënësve, prindërve, institucioneve që merren me arsim dhe më së shumti do t’ju ndihmojnë nxënësve në ngritjen e cilësisë në të nxënit.

Fjalët kyçe: Vlerësimi i vazhdueshëm, teknika, kurrikula, Edukata Qytetare.